

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7934  
E martë, 19 nëntor 2024  
Çmimi 0.50

## Riho Terras nga Estonia emërohet raportues për Kosovën në PE



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KOSOVA DHE MAQEDONIA E VERIUT NËNSHKRUAJNË TRI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

FAQE 4-5



Në takim e 18 nëntorit në Prishtinë, qeveritë e dy vendeve i kanë nënshkruar tri marrëveshje bashkëpunimi. Palët kanë nënshkruar marrëveshje në fushën

e energjisë, të arsimit dhe për lehtësimin e lëvizjes së lirë. Kurti ka thënë se zbatimi do të nisë nga janari i vitit 2025. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se

vendi i tij nuk ka asnjë mosmarrëveshje me Maqedoninë e Veriut dhe kanë komunikim të vazhdueshëm për tema me interes të përbashkët

## HESHTJA KRITIKE NË BE PËR KOSOVËN DHE SERBINË

F. 5



## KURTI: ATA QË JANË PASURUAR NË DËM TË POPULLIT DO T'I PËRGJIGJEN BYROSË PËR KONFISKIMIN E PASURISË

F. 3



## AKTUALE



### BAERBOCK: VENDIMI I SHBA-së PËR ARMË ME RREZE TË GJATË PËR UKRAINËN, I RËNDËSISHËM

F. 2

### SHËNDETI MENDOR I FËMIJËVE, QELAJ: KA MUNGESË TË MEKANIZMAVE PËR IDENTIFIKIMIN E HERSHËM

F. 7

### BANKA BOTËRORE NIS NË SHQIPËRI PROGRAMIN PËR URAT E QËNDRUESHME

F. 6

### PROCESI I RIKREDITIMIT, SHUMË TAKIME PËR NJË UNIVERSITET TË SHEKULLIT XXI

F. 7

## EKONOMI



### BIE INDEKSI I PËRGJITHSHËM I INPUTEVE BUJQËSORE

F. 8

### AKK-JA: BUXHETI 2025, I PAMJAFTUESHËM PËR KOMUNAT

F. 8

## SPORT



### KOSOVA TRIUMFON NDAJ LITUANISË

F. 10

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Baerbock: Vendimi i ShBA-së për armë me rreze të gjatë për Ukrainën, i rëndësishëm

**BERLIN, 18 NËNTOR** - Shtetet e Bashkuara e kanë ndërmarrë një hap të rëndësishëm në lidhje me mbështetjen ushtarake për Ukrainën, tha të hënën ministria e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock. Administrata e presidentit Joe Biden e ka lejuar Ukrainën t'i përdorë armët e prodhuara amerikane për të kryer sulme thellë brenda Rusisë, thanë mediet amerikane të dielën. Baerbock, megjithatë, tha se kjo nuk përbën ndryshim të strategjisë nga Perëndimi. "Vendimi nga pala amerikane - dhe dua ta theksoj se ky nuk është rimendim, por thjesht

intensifikim i asaj që kanë dhënë deri tani partnerët e tjerë - është tejet i rëndësishëm në këtë kohë", tha Baerbock në Bruksel para takimit me ministrat e Jashtëm të BE-së. "The New York Times", "Associated Press" dhe "Reuters" raportuan më 17 nëntor se Bideni ka hequr këto kufizime, duke u thirrur në burime që kanë njohuri për këtë çështje. Shtëpia e Bardhë ende nuk ka komentuar për këto raportime dhe nuk i është përgjigjur ende kërkesës për koment dërguar nga "Radio Evropa e Lirë".

Këshilli për Siguri Kombëtare, po ashtu, nuk ka komentuar për këtë raportime. Nëse ky lajm konfirmohet, atëherë do të përbente një ndryshim të madh në politikën amerikane, pasi Kiev i që një kohë të gjatë i ka kërkuar Uashingtonit që ta lejojë të përdorë armë me rreze të gjatë veprimi për ta sulmuar Rusinë. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky nuk i konfirmoi drejtpërdrejt raportimet, por tha se një nga pikat kryesore të "planit të tij të fitores" që ua ka paraqitur aleatëve përfshinte përdorimin e armëve me rreze të gjatë veprimi nga ushtria e



tij. Ukraina po u kërkon partnerëve të saj t'ia heqin kufizimet për përdorimin e armëve të tyre për të sulmuar

objektiva brenda Rusisë. Nëse ata i japin dritën e gjelbër, harta e mëposhtme tregon se sa larg mund të arrijnë disa prej armëve perëndimore.

## Trumpi emëron Chris Wright sekretar të Energjisë

**WASHINGTON, 18 NËNTOR** - Presidenti i zgjedhur Donald Trump zgjodhi Chris Wright, themelues i një kompanie në fushën e naftës, për ta drejtuar Departamentin e Energjisë, ndërsa administrata e tij e re vazhdon të marrë formë. Ekipi i tranzicionit i Trumpit njoftoi zyrtarisht këtë emërim të shtunën. Javën e kaluar presidenti i zgjedhur Trump njoftoi për ngritjen e Këshillit Kombëtar të Energjisë, që do të drejtohet ish-governatori i Dakotës së Veriut, Doug Burgum, i propozuar për pozitën e Sekretarit të Brendshëm. Në këtë rol Burgum do të drejtojë një strukturë që shtrihet në të gjitha agjencitë e degës ekzekutive, të përfshira



në çështje që lidhen me lejet për energjinë, prodhimin, shpërndarjen, transportin dhe rregulloret në këtë fushë, shprehej zoti Trump nëpërmjet një deklaratë. Si

kryetar i Këshillit Kombëtar të Energjisë, zoti Burgum do të ketë një vend në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, tha presidenti i zgjedhur. Wright, drejtor ekzekutiv i

kompanisë "Liberty Energy" me bazë në Denver të Kolorados, nuk ka përvojë politike dhe ka shkruar gjerësisht mbi nevojën për rritjen e prodhimit të energjisë nga burime jo të rinovueshme, për t'i nxjerrë njerëzit nga varfëria. Prodhimi i naftës në ShBA arriti nivelin më të lartë që një vend ka prodhuar ndonjëherë gjatë administratës së presidentit Biden dhe është e paqartë se sa do të arrijë sekretari i ri i Energjisë dhe administrata e ardhshme ta shtojnë prodhimin e naftës. Shumica e vendimeve për shpimin e naftës merren nga kompani private që punojnë në tokë që nuk është në pronësi të qeverisë federale.

Departamenti i Energjisë merret me diplomacinë energjetike të Shteteve të Bashkuara, administron Rezervën Strategjike të Naftës dhe drejton programe grantesh dhe huash për t'i avancuar teknologjitë e energjisë, siç është Zyra e Programeve të Huas. Sekretari, gjithashtu, mbikëqyr kompleksin e armëve bërthamore të ShBA-së, asgjësimin e mbetjeve të energjisë bërthamore dhe 17 laboratorë kombëtarë. Kërkesa për energji elektrike në Shtetet e Bashkuara shtohet për herë të parë në dy dekada, ndërsa po shtohet përdorimi i inteligjencës artificiale dhe automjeteve elektrike.

## Demokratët bëjnë analizën e humbjes në zgjedhje

**WASHINGTON, 18 NËNTOR** - Demokratët po shqyrtojnë arsyet që çuan në humbjen e garës presidenciale më 5 nëntor. Analistët rendisin ekonominë si arsye kryesore për humbjen e nënpresidentes Kamala Harris, por shtojnë se pas saj qëndrojnë edhe faktorë të tjerë. Ndërsa demokratët po mësohen gradualisht me realitetin e humbjes së zgjedhjeve, ata po reflektojnë mbi arsyet e kësaj humbjeje. Shtëpia e Bardhë i ka kundërshtuar pohimet se përpjekja e presidentit Joe Biden për t'u rizgjedhur dhe hezitimi i tij për t'u tërhequr nga gara presidenciale më herët, dëmtuan mundësinë e nënpresidentes Kamala Harris për të fituar, më 5 nëntor. "Kur ai mori vendimin për t'ia

kaluar stafetën nënpresidentes, ai besoi se ishte vendimi i duhur për të marrë në atë kohë", tha Karine Jean-Pierre, sekretare e Shtypit e Shtëpisë së Bardhë. Por sipas analistëve, mundësitë për t'u zgjedhur të Harrisit u dëmtuan më shumë nga fakti se ajo nuk arriti ta ndajë veten nga politikat ekonomike të Bidenit. "Perceptimi popullor ishte se ai nuk e ka menaxhuar mirë ekonominë, gjë që më së shumti buronte nga inflacioni i lartë i dy viteve të tij të para në detyrë. Mendoj se ato ishin pengesa shumë të vështira për t'u kapërcyer nga Harrisit", thotë David Greenberg i Universitetit 'Rutgers'. Gjatë fushatës elektorale vëmendje e madhe iu kushtua të drejtës për abort, por gratë nuk votuan për Harrisin lidhur



me këtë çështje në atë masë që kishin shpresuar demokratët. "Kishte shumë shtete që këtë çështje e kishin në fletëvotim, me qëllimin për ta përcaktuar me ligj të drejtën riprodhuese, ndaj njerëzit ishin në gjendje të votonin për këtë çështje dhe në të njëjtën kohë të votonin për Trumpin", thotë Julie Roginsky, zyrtare demokrate.

Roginsky thotë se përtej analizës së asaj se çfarë ndodhi me këto zgjedhje, Partia Demokrate duhet të rregullojë atë që ajo e quan, një problem strukturor që ekziston prej kohësh. "Ne kemi një historik me të cilin duhet të krenohemi, megjithatë nuk dimë si ta përcjellim atë. Nuk po ia dalim

ta përçojmë mesazhin e të shfaqemi si autentikë", shton ajo. John Lappie, profesor i asocuar i shkencave politike në Universitetin Shtetëror të Plymouth, thotë se demokratët kanë nevojë për gjak të ri. "Ata kanë nevojë për udhëheqje të re, e cila duhet të jetë më në harmoni me situatën aktuale dhe padyshim në harmoni me klasën punëtore". Në kushtet kur republikanët udhëheqin Kongresin me një shumicë të vogël, Lappie pret që demokratët të jenë në gjendje t'i kundërshtojnë politikën me të cilat nuk pajtohen, ndërkohë që përgatiten për goditjen e tyre të radhës në zgjedhjet afatmesme të vitit 2026, që përkojnë me mesin e mandatit të një presidenti.

# Kosova dhe Maqedonia e Veriut nënshkruajnë tri marrëveshje bashkëpunimi

Në takim e 18 nëntorit në Prishtinë, qeveritë e dy vendeve i kanë nënshkruar tri marrëveshje bashkëpunimi. Palët kanë nënshkruar marrëveshje në fushën e energjisë, të arsimit dhe për lehtësimin e lëvizjes së lirë. Kurti ka thënë se zbatimi do të nisë nga janari i vitit 2025. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se vendi i tij nuk ka asnjë mosmarrëveshje me Maqedoninë e Veriut dhe kanë komunikim të vazhdueshëm për tema me interes të përbashkët

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se vendi i tij nuk ka asnjë mosmarrëveshje me Maqedoninë e Veriut dhe kanë komunikim të vazhdueshëm për tema me interes të përbashkët. Ai i ka bërë këto deklarata në një konferencë të përbashkët për medie me homologun maqedonas Hristijan Mickoski.

Në takim e 18 nëntorit në Prishtinë, qeveritë e dy vendeve i kanë nënshkruar tri marrëveshje bashkëpunimi.

Palët kanë nënshkruar marrëveshje në fushën e energjisë, atë të arsimit, dhe për lehtësimin e lëvizjes së lirë. Kurti ka thënë se zbatimi do të nisë nga janari i vitit 2025. "Pas shumë kohe pritjeje, më në fund do të kemi

kontroll të përbashkët në pikat Han i Elezit - Bllacë dhe Jazhincë - Gllboçicë. Ky model kontrolli bëhet vetëm hyrje-hyrje dhe zyrtarët policorë punojnë në të njëjtën ndërtesë duke lehtësuar kalimin kufitar dhe, rrjedhimisht, duke shkurtuar kohën e pritjes", ka thënë Kurti.

Kurti ka thënë se protokoli për energjinë përbën "hap të rëndësishëm për forcimin e sigurisë së furnizimit me energji për dy vendet tona". "Të dyja ministratë do të angazhohen për t'i adresuar sfidat e energjisë duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për arrijen e objektivave të përbashkëta. Po zotohemi të nxisim projekte për energjinë e ripërtërishme dhe efikasitet energjetike, si dhe për ta thelluar bashkëpunimin e ekspertëve në mes të korporatave tona të energjisë".

Për memorandum për arsimin, Kurti ka thënë se fokusi do të jetë në aftësim profesional dhe aftësim të të rriturve.

Mickoski e ka lavdëruar gjithashtu takimin dhe ka thënë se marrëveshjet e arritura do të kenë ndikim pozitiv për njerëzit dhe përparimin ekonomik. "Të bisedojmë për të ardhmen, në vend që të flasim për të kaluarën. Qytetarët kanë probleme të përbashkëta, prandaj do të kemi zgjidhje të përbashkëta", ka thënë Mickoski.

Përgjatë mbledhjes mes dy qeverive, Kurti ka përmendur se dy vendet i kanë nënshkruar 50 marrëveshje deri më tani, por "ajo që duhet të bëjë tash është zbatimi i tyre". "Marrëdhëniet e mira mes dy vendeve tona pasqyrohen edhe në rritjen e vazhdueshme të tregtisë, e cila arriti në 432 milionë euro në vitin 2023, një rritje e jashtëzakonshme prej 52-përqindësh, krahasuar me vitin 2019, ku qëndronte 284 milionë euro", ka deklaruar Kurti. Sipas tij, ka pasur rritje të eksportit nga Kosova në Maqedoninë e Veriut, nga 48

milionë në vitin 2019, në 121 milionë në vitin 2023. "Në Maqedoninë e Veriut e shohim një vend më mirë, me të cilin jemi të lidhur, jo vetëm përmes gjeografisë, por edhe nga vlerat e përbashkëta dhe nga njerëzit tanë. Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut duhet t'i shohim si vlera e shtuar, si ura të bashkëpunimit më të ngushtë dhe më të fuqishëm mes vendeve tona", ka thënë ai.

Pjesë e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut është edhe koalicioni shqiptar VLEN, i cili përbëhet nga partitë Alternativa, Lëvizja Besa, Lëvizja Demokratike dhe Aleanca për Shqiptarët. Shqiptarët përbëjnë rreth 29.5 për qind të popullsisë prej 1.8 milion të Maqedonisë së Veriut. Kryeministri maqedonas tha se kanë treg të përbashkët prej 17-18 milionë eurosh, dhe shtoi se u pajtua me Kurtin gjatë një takimi dypalësh që ky bashkëpunim tregtar të rritet në rreth 500 milionë euro. "Nëse punojmë së bashku do të jemi më të fuqishëm, meqë uniteti i bënë fëqinjët edhe më të fuqishëm. Synojmë që bashkëpunimi tregtar të jetë edhe më i madh në vitet në vijim

dhe do të na sjellë përfitime. Jam i bindur që do t'ia dalim", tha Mickoski.

Takimi i përbashkët i dy qeverive vjen pas një vizite që Kurti me ministrat e tij e bëri në Shkup këtë verë, pak muaj pasi ishte formuar qeveria e Mickoski.

Ky është takimi i dytë ndërqeveritar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut pas atij në vitin 2021.

Gjatë konferencës, Kurti është pyetur edhe pse është vendosur të mbahet tani takimi mes dy qeverive, kur po diskutohet Ligji i Gjuhëve në Shkup. Kurti ka thënë se çështja e gjuhës i takon Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut, pasi tri dispozita të Ligjit për Gjuhët janë dërguar në Komisionin e Venecias. "Në Maqedoni të Veriut nuk ka ligj për përdorim të gjuhës shqipe dhe nuk ka pasur as në të kaluarën. Ekziston Ligji për Përdorim të Gjuhëve, që e përmend shifrën 20 për qind, por nuk është ligj për përdorim të gjuhës shqipe, është për përdorim të gjuhëve", ka thënë Kurti, duke shtuar se pret vendim të drejtë, që nuk bën përjashtime dhe respekton shumëgjuhësinë.



## Kurti: Ata që janë pasuruar në dëm të popullit do t'i përgjigjen Byrosë për Konfiskimin e Pasurisë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në Konferencën Rajonale "Praktikat më të Mira për Parandalimin e Korrupsionit - nga Politika në Veprim Rajonal për Parandalimin e Korrupsionit", i organizuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP, në Kosovë.

Në fjalën e tij në kuadër të ngjarjes, kryeministri Kurti tha fillimisht se minimi i demokracisë e i të drejtave dhe lirive të njeriut që vjen si pasojë e korrupsionit, ndikon edhe në rritje të përgjithshme ekonomike e të përparimit të shoqërisë, ndërsa jo shumë kohë më parë, konkretisht në vitet 2018-2019, Kosova është paraqitur në dokumentet politike të



ekspertëve të Bashkimit Evropian si shtet i kapur. "Korrupsioni në Kosovë ishte i strukturuar, duke filluar nga nivelet më të larta dhe përfshinte një gamë të gjerë

agjencish shtetërore. Lidhjet horizontale ndërmjet disa degëve të shtetit dhe qeverisë, që përfshinin edhe aktorë ekonomikë nga sektori privat, po e shpërbënin shtetin si

arbitër të pavarur të konflikteve shoqërore. Struktura administrative hierarkike ishin të kontrolluara politikisht dhe ishin llogaridhënëse ndaj linjës vertikale të pushtetit e jo ndaj qytetarëve, të cilëve institucionet publike duhet që t'i shërbejnë," tha kryeministri.

Më tej, ai tha se këto tashmë i kemi ndaluar dhe nuk do të kthehen më, gjersa pas vetëm një viti qeverisjeje të suksesshme u patëm ngritur për 20 numra në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International dhe jemi renditur të parët në rajon për sundim të ligjit sipas World Justice Project. "Duke u përqendruar te fuqizimi i shtetit e jo i grupeve të interesit apo strukturave paralele dhe te pasurimi i qytetarit e jo i politikanëve dhe i familjeve të tyre,

ne kemi arritur ta konfirmojmë besimin qytetar të evidentuar edhe në Pulsin Publik të UNDP-së të korrikut të vitit 2024 ku më shumë se 50 % e qytetarëve tregojnë që i besojnë qeverisë së tyre dhe liderëve të shtetit", shtoi kryeministri.

Kryeministri Kurti theksoi se sot korrupsioni nuk listohet më si një ndër problemet më të mëdha të shtetit siç ishte gjatë kohës së qeverive paraprake. Tha se ata që janë pasuruar në dëm të popullit do t'i përgjigjen Byrosë për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, e cila do të hyjë në fuqi së shpejti si mekanizëm i fuqishëm i shoqërisë sonë demokratike për t'ia kthyer pasurinë popullit, pasurinë që ia zhatën politikanët e që nuk iu përket atyre, por qytetarëve të vendit tonë.



## Heshtja kritike në BE për Kosovën dhe Serbinë

Drejtimin e politikës së jashtme të BE-së tani pritet ta marrë ish-kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas. Njohësit ndërkombëtarë thonë se Kallas nuk do ta ketë prioritet dialogun Kosovë - Serbi, por shtojnë se është e rëndësishme që ajo të mos e neglizhojë plotësisht këtë proces

**PRISHTINË, 18 NËNTOR** - Që nga viti 2011 kur kanë nisur bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë janë zhvilluar nën ndërmjetësimin e tre shefave të ndryshëm të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian: Catherine Ashton, Federica Mogherini dhe Josep Borrell. Secili ka dhënë kontributin e vet, dhjetëra takime janë zhvilluar, po aq marrëveshje janë arritur. Por, mbërritja te qëllimi përfundimtar mbetet ende larg. Udhëheqësit politikë të negociatave, Albin Kurti i Kosovës dhe Aleksandar Vuçiqi i Serbisë, nuk janë takuar qysh më 14 shtator të vitit 2023. Dhjetë ditë më vonë ka ndodhur sulmi në Banjskë, ku grupe të armatosura serbësh kanë sulmuar Policinë e Kosovës dhe kanë vrarë një polic. Ky përshkallëzim i situatës - më i rëndi ndër vite - i ka çuar pastaj marrëdhëniet mes dy vendeve në pikë kritike. Shefi në largim i politikës së jashtme të BE-së, Borrell, ka bërë përpjekjen e fundit më 26 qershor, për t'i ulur bashkë Kurtin dhe Vuçiqin, por pa

sukses. "Ka qenë takimi i njëmbëdhjetë i liderëve që kam kryesuar unë. Pra, takim me liderët, jo mes tyre. Sepse, kësaj radhe, nuk ka pasur takim trepalësh", ka thënë Borrell. Drejtimin e politikës së jashtme të BE-së tani pritet ta marrë ish-kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas. Ajo është shfaqur këtë javë në seancë dëgjimore para Parlamentit Evropian, ka folur për luftën në Ukrainë, për konfliktin në Lindjen e Mesme, për rrezikun nga Kina, për forcimin e mbrojtjes në Evropë e çështje të tjera por, çuditërisht, fare pak për Ballkanin Perëndimor - rajonin ku BE-ja ka shumë ndikim dhe është e përfshirë në disa procese, përfshirë ndërmjetësimin e bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ajo nuk ka thënë asgjë konkrete për këtë dialog që do ta kryesojë vetë, vetëm është zotuar që zgjerimi i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor do të bëhet realitet. "Unë mendoj se vërtet duhet të kemi një tregim suksesi në pesë vjetët e ardhshëm, sepse kjo nuk është vetëm për prosperitetin e rajonit, por edhe për t'i dhënë shpresë

atij", ka thënë Kallas. Rikard Jozwiak, redaktor për Evropën i Radios Evropa e Lirë, thotë se është i befusuar nga shpërfillja e Ballkanit Perëndimor në fjalimin për politikën e jashtme të BE-së. Ai thotë se ka pritur që Kallas ta përmendte atë përkrah rajoneve të tjera të rëndësishme, si Ukraina dhe Lindja e Mesme. Për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, po ashtu, ka pritur vëmendje të posaçme. "Fakti që nuk e ka përmendur Ballkanin Perëndimor gjatë fjalimit hyrës, që ka zgjatur 15 minuta, dhe më pas ka pasur vetëm një pyetje për të nga eurodeputetët, mua më ka tronditur. Ngjashëm edhe fakti se asnjë deputet i Parlamentit Evropian nuk duket se është i interesuar për një rajon që është shumë pranë BE-së", thotë Jozwiak. Në mesin e sfidave më urgjente politike, Leon Hartwell, bashkëpunëtor i lartë në LSE IDEAS - Shkolla e Londrës për Ekonomi, thotë se Kallas, me gjasë, ka zgjedhur t'u japë përparësi çështjeve të sigurisë së BE-së në tërësi dhe ta lërë pak mënjonë dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Çështjet që sigurisht do ta dominojnë kohën e saj në detyrë, janë lufta e vazhdueshme mes Rusisë dhe Ukrainës, marrëdhëniet mes BE-së dhe ShBA-së, sidomos pas fitores së Donald Trumpit në zgjedhjet presidenciale, pastaj Kina do të mbetet një çështje e rëndësishme, siguria

energjetike, e kështu me radhë. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të ketë vëmendje të menjëhershme nëse nuk ka probleme me sigurinë të cilat janë shumë të mundshme", thotë Hartwell për programin "Expose" të "Radios Evropa e Lirë". Vitet e fundit përshkallëzimi i tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë ka gjeneruar vazhdimisht sfida dhe konflikte. Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje përshtur përfaqësuesve të të dyja vendeve që zgjidhjen ta kërkojnë përmes negociatave. Pavarësisht prej atyre thirrjeve, zgjidhja e qëndrueshme mbetet larg dhe BE-ja nuk e ka luksin ta lërë anash dialogun për kohë të gjatë, thotë Hartwell. "Potenciali për destabilitet është mjaft i lartë dhe definitivisht kjo nuk është një çështje për t'u neglizhuar. Aq më tepër kur khet parasysht se rajoni i Ballkanit është një zonë e cenueshme e Evropës. Çfarëdo që ndodh në Ballkan, nuk mbetet vetëm në Ballkan, por ka efekt të madh të shtrirjes edhe në pjesën tjetër të Evropës", thotë Hartwell. Kryeministri i Kosovës, Kurti, ka nxjerrë disa kushte për vazhdimin e dialogut - mes tyre edhe dorëzimin nga Serbia të personave përgjegjës për sulmin në Banjskë. Në disa raste ai e ka akuzuar Bashkimin Evropian se "përkëdhel" Serbinë, të cilën BE-ja e ka mohuar. Gjatë një adresimi muajin e kaluar, ai ka

thënë se pret dinamikë të re nga Komisioni i ri Evropian sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, por nuk ka specifikuar më shumë. Presidenti i Serbisë, Vuçiq, në anën tjetër, kërkon vazhdimisht nga Kosova ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, për të cilin ka një marrëveshje qysh në vitin 2013. Jozwiak beson se shumë lëvizje në procesin e dialogut do të shtohen pasi Kosova t'i përfundojë zgjedhjet parlamentare në shkurt të vitit 2025. I pyetur se çfarë mund t'i shtyjë gjërat përpara, Jozwiak kujton një bisedë me ish-shefen e politikës së jashtme të BE-së, Catherine Ashton, e cila ka ndërmjetësuar marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë: "Ajo ka thënë se salca sekrete është të angazhohesh dhe të bisedosh, e të bisedosh, e të bisedosh dhe t'i njohësh dy udhëheqësit. Tani kemi - le t'i quaj - dy burrështetas të fortë në Kosovë dhe Serbi, që kanë mbështetje të madhe në vendet e tyre". "Ata dy burra do të bëjnë ose nuk do të bëjnë marrëveshje. Dhe Kaja Kallas, ose kushdo që është në pozitën e saj, do të duhet të pijë shumë kafe me ta ose edhe gjëra të tjera", thotë Jozwiak. Për Hartwellin, topi është fillimisht në anën e BE-së. Sipas tij, Kallas duhet t'i nxisë

# Riho Terras nga Estonia emërohet raportues për Kosovën në PE

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Eurodeputeti estonez nga Partia Popullore Evropiane (PPE), Riho Terras, është emëruar të hënën raportues për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE). Parlamentin Evropian e kompletoi të hënën listën e raportuesve për vendet e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE). Për emërimin e tij në këtë pozitë u pajtuan në grupin e PPE-së në Komisionin për Politikë të Jashtme. Riho Terras është ish-ushtarak

nga Estonia, i cili ka qenë deputet edhe në përbërjen paraprake të Parlamentit Evropian. Më herët grupet politike në PE ishin pajtuar t'i ndajnë mes vete postet e raportuesve për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Pas kësaj, secili grup vendosi nga radhët e veta të emërojë një raportues për shtetin përkatës. Grupit të PPE-së kësaj radhe i takon posti i raportuesit për Kosovën. Tradicionalisht, në 20 vjetët e fundit, raportuesi për Kosovën gjithmonë ka qenë

nga radhët e Grupit të Gjelbërve. Ky grup shënoi rënie të mbështetjes në zgjedhjet e fundit për PE të mbajtura më herët gjatë këtij viti. Nga radhët e EPP-së si raportues për Bosnjë-Hercegovinë është caktuar deputeti Onderj Kolar nga Çekia. Raportues për Serbinë në PE është caktuar të jetë deputeti socialdemokrat nga Kroacia, Tonino Picula. Nga pushteti në Serbi ka pasur reagime të ashpra, shpesh edhe fyese, pas emërimit të këtij ish-

ministri të Jashtëm të Kroacisë si raportues për këtë vend. Për Maqedoninë e Veriut raportues do të jetë deputeti i gjelbër, Thomas Waitz nga Austria. Deputeti liberal nga Sllovenia, Marjan Sharec, do të jetë raportues për Malin e Zi. Raportues për Shqipërinë do të jetë deputeti nga Austria, Andreas Shrieder. Raportues për Ukrainën do të jetë Mikhael Gahler nga EPP, për Moldavinë Sven Mikser nga radhët e Socialistëve dhe Demokratëve, për Gjeorgjinë Rasa Jukneviçiene nga EPP,

ndërsa për Turqinë Nacho Sanchez Amor nga Socialistët dhe Demokratët. Këta raportues në pesë vjetët e ardhshme do t'i ndjekin për së afërmi zhvillimet në vendet përkatëse dhe do t'i përpilojnë raportet vjetore. Përmes këtyre raporteve do të vlerësohet përparimi i këtyre vendeve në procesin e reformave dhe në përmbushjen e kriterëve për integrim në Bashkimin Evropian. Këto raporte pastaj miratohen edhe si rezoluta të Parlamentit Evropian.



pesë vendet mosnjohëse të bllokut - Greqinë, Sllovakinë, Spanjën, Qipron dhe Rumaninë - që ta njohin Kosovën dhe, në këtë mënyrë, t'i bëjnë trysni Serbisë për të hequr dorë nga refuzimi për njohjen e Kosovës. "Për aq kohë sa Serbia e sheh Kosovën si pjesë të territorit të saj, ajo e ka për detyrë të mbrojë çdo gjë që ndodh në atë territor dhe kjo krijon një situatë pasigurie. Kjo është e para". "E dyta, çdo marrëveshje që BE-ja promovon në mes të Serbisë dhe Kosovës, duhet të jetë një hap përpara drejt njohjes së Kosovës. Kallas nuk mund të

fokuset në ruajtjen e status quo-së. Ajo duhet ta shtyjë përpara reciprocitetin", thotë Hartwell. Për më shumë se një dekadë negociata, Kosova dhe Serbia kanë arritur dhjetëra marrëveshje - nga lëvizja e lirë deri te njohja e simboleve shtetërore - por shumë prej tyre mbeten pa u zbatuar dhe palët akuzojnë njëra-tjetrën për mosangazhim. Asnjëri prej bashkëbiseduesve nuk pret që, në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi, Bashkimi Evropian ta rrisë bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara, të cilat nga janari

do të kenë, po ashtu, administratë të re. Jozwiak shpreh skepticizëm për interesin aktual të ShBA-së për t'u angazhuar në këtë çështje. "Do të kishte kuptim që BE-ja dhe ShBA-ja të ishin në të njëjtën faqe në Ballkanin Perëndimor. Por, kam ndjesinë se dialogu do t'i mbetet BE-së. Nuk jam i sigurt se ShBA-ja ka ndonjë interes real për të qenë në krye kur bëhet fjalë për Ballkanin Perëndimor. Ndoshta do të ndryshojë", thotë Jozwiak. Me fjalët e profesorit Hartwell, Kaja Kallas, si estoneze që është, "e di mirë se çfarë do të

thotë të jetosh pranë një fqinji shumë të madh, që paraqet kërcënim të vazhdueshëm ekzistencial për sigurinë tënde". Ai i referohet këtu Rusisë, e cila ndan një kufi prej gati 300 kilometrash me Estoninë. Hartwell shprehet i bindur se Kallas nuk do ta ketë prioritet dialogun Kosovë - Serbi, por thekson se është e rëndësishme që të mos e neglizhojë plotësisht. Një qasje proaktive jo vetëm se do t'i qetësonte tensionet mes dy vendeve, por do të ndihmonte edhe në qëndrueshmërinë e rajonit në përgjithësi, sipas tij.

Në një takim me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, në vitin 2021, kryeministrja e atëhershme e Estonisë ka theksuar nevojën e përmirësimit të marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, me arsyetimin se një Ballkan Perëndimor i sigurt "është në interesin e gjithë Evropës". Se edhe sa kohë do t'u duheshin negociatave që kanë nisur qysh në vitin 2011 dhe kanë prodhuar shpesh pasiguri në vend të zgjidhjeve, nuk e thotë askush. Por, të shpresojmë që jo edhe 13 vjet të tjerë.

# Objektivat strategjikë të Kosovës: Anëtarësimi në OKB, NATO dhe avancimi në procesin e integritit evropian



Nga Washington DC:  
Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Objektivat strategjikë të Kosovës, përfshirë anëtarësimin në OKB, NATO dhe avancimin drejt integritit evropian, kërkojnë një qasje të integruar dhe të koordinuar me aleatët ndërkombëtarë. Një strategji gjithëpërfshirëse, e cila adreson

sfidat dhe shfrytëzon mundësitë, është kyçe për suksesin në këto fusha.

Anëtarësimi në OKB përbën një hap vendimtar për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Megjithatë, ky objektivi përballet me sfida të mëdha diplomatike, përfshirë kundërshtimin e disa shteteve anëtare. Për të përparuar drejt këtij qëllimi, Kosova duhet të: Të

përqendrojë përpjekjet te vendet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë, duke shfrytëzuar mbështetjen e SHBA-së dhe vendeve kyçe të BE-së.

Të thellojë bashkëpunimin me aleatët që mund të ndikojnë në qëndrimet e vendeve skeptike. Përmirësimi i marrëdhënieve me Serbinë mund të krijojë një kontekst më të favorshëm për diplomacinë dhe legjitimitetin ndërkombëtar të Kosovës.

Për të garantuar siguri dhe stabilitet afatgjatë, Kosova duhet të përshejtojë procesin e anëtarësimi në NATO. Hapat kyç për këtë qëllim janë: Përmes pjesëmarrjes në programe si Partneriteti për Paqe dhe përmbushjes së standardeve të sigurisë.

Transformimi i FSK-së në një ushtri të standardeve të NATO-s përmes trajnimeve dhe pajisjeve moderne.

Forcimi i marrëdhënieve me vende si Greqia dhe Turqia, që luajnë një rol vendimtar në vendimmarrjen e Aleancës.

Integriti në BE është thelbësor për zhvillimin ekonomik dhe institucional të Kosovës. Përparimi në këtë drejtim kërkon: Prioritetin e duhet dhënë sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe përmirësimit të administratës publike.

Respektimi i marrëveshjeve ekzistuese mund të forcojë besimin e BE-së në angazhimin e Kosovës.

Forcimin e marrëdhënieve me vendet influente të BE-së: Ndërtimi i aleancave strategjike me Gjermaninë, Francën dhe shtete të tjera kyçe mund të jetë një hap i rëndësishëm.

Bashkëpunimi i ngushtë me SHBA-në dhe BE-në është vendimtar për realizimin e këtyre objektivave. Strategjia duhet të përfshijë: Shmangie të njëanshmërisë në zbatimin e marrëveshjeve dhe kërkim të reciprocitetit.

Për të adresuar kundërshtimin e Rusisë dhe Kinës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Ndërtimi i dialogut me vende që kanë rezerva për njohjen dhe

mbështetjen e Kosovës.

Për të ndërtuar një strategji të qëndrueshme, Kosova mund të mësojë nga përvoja e vendeve të tjera:

Kroacia dhe Sllovenia: Përmes diplomacisë intensive, siguruan njohje ndërkombëtare dhe integritet në organizata ndërkombëtare.

Mali i Zi: Transformimi i ushtrisë dhe bashkëpunimi me NATO-n çuan në anëtarësim të suksesshëm.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut: Reformat e brendshme hapën rrugën për negociata me BE-në.

Kosova ka potencial për të arritur objektivat e saj strategjikë përmes një kombinimi të reformave të brendshme, diplomacisë aktive dhe bashkëpunimit të ngushtë me aleatët ndërkombëtarë. Një qasje e balancuar dhe gjithëpërfshirëse, që reflekton përkushtimin ndaj stabilitetit dhe integritit global, do të garantojë një të ardhme të qëndrueshme për vendin.

## Banka Botërore nis në Shqipëri programin për urat e qëndrueshme

Tiranë, 18 nëntor - Në Shqipëri nisën punimet në kuadër të një projekti që mbështetet nga Banka Botërore për ndërhyrjet për urat e qëndrueshme. Ura e Viroit në Gjirokastrë është e para që ka nisur të ndërtohet, ndërsa pritet të ndërhyhet edhe në rreth 30 ura të tjera të rëndësishme të vendit.

Banka Botërore ka dhënë një hua prej 100 milionë dollarë për ndërhyrjet që pritet ta rrisin sigurinë e urave në shtatë vitet e ardhshme.

Në zonën e parkut natyror të Viroit në Gjirokastrë kanë nisur punimet për ndërtimin e një ure të re paralelisht me një urë ekzistuese që përmbijet gjatë dimrit dhe sillte probleme për këtë segment të rëndësishëm rrugor.

Projekti është pjesë e një programi për qëndrueshmërinë e urave në Shqipëri, të ndërmarrë nga qeveria shqiptare me një hua të Bankës Botërore, në vlerën e rreth 100 milionë dollarëve, i cili pritet të zgjasë shtatë vjet. "Projekti i zbatimit është i rëndësishëm pasi krijon një urë të re me standarde, ndërsa ura ekzistuese do të shërbejë si shëtitore panoramike përreth liqenit", thotë inxhinieri Aristotel Noni në Autoritetin Rajonal Rrugor. "Objektivat kryesorë që zgjidh ky projekt

janë: Së pari zgjidh problemin gjeometrik të rrugës, pasi kemi të bëjmë aktualisht me një rrugë shumë të ngushtë me parametra shumë të disfavourshëm gjeometrikë. Do të ndërtohet një rrugë e re, bashkëkohore, me parametra të kënaqshëm gjeometrikë. Së dyti zgjidh problemin e përmbijetjes pasi në këtë zonë prej shumë vitesh ka pasur probleme shumë të mëdha deri në bllokimin e segmentit kombëtar rrugor gjatë shirave intensive. Së treti zgjidh problemin e kalimit të këmbësorëve. Zona, duke qenë Monument Natyre, ka vizitueshmëri të lartë dhe me ndërtimin e urës së re, ura e vjetër do të përdoret për këmbësorët që i vijnë rreth e qark lehtësisht liqenit pas përfundimit të këtij projekti", tregon ai.

Sipas Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri, nga programi do të ndërhyhet në 30 ura e para që kanë nevojë të menjëhershme, ndërkohë që rreth 800 mijë banorë kanë një përfitim të drejtpërdrejtë.

Urat ku pritet të ndërhyhet sipas vlerësimit të Bankës Botërore kërkojnë rehabilitime të mëdha, përmirësime apo rindërtim nga e para.

Inxhinieri Noni thotë se disa ura në Qarkun e Gjirokastrës kanë



nevoja për ndërhyrje, ndërsa në kuadër të këtij programi në këtë qark është përfutur edhe një urë tjetër në zonën e Dragotit. "Problematika dhe amortizim ka në disa ura, kryesisht disa ura metalike që ndodhen në Qarkun tonë si Ura e Dragotti dhe Ura e Leklit. Nga ana jonë janë bërë kërkesa vazhdimisht për rehabilitimin e këtyre urave ose për devijimin e rrugës nëpërmjet aksit të ri Tepelenë - Dragot", tha ai.

Qeveria shqiptare e ndërmori programin e urave të qëndrueshme pas tërmetit të vitit 2019 duke vlerësuar se 80 ura të rëndësishme në vend kishin përparësi për ndërhyrje pasi kishin një ritëm të trafikut nga 100 deri në 2500 mjete në ditë dhe probleme të mëdha me

amortizimin e tyre.

Gjendja e shumë prej urave të vlerësuar nga ekspertët "dëshmon për dobësi dhe rrezik për shkak të kushteve të tyre të përkeqësuar strukturore apo në zona të prekura nga fatkeqësitë natyrore apo ndryshimet klimatike".

Por ndërsa për urat e rëndësishme rrugore po nis zbatimin e ndërhyrjeve, ekspertët e trashëgimisë kulturore vlerësojnë se dhjetëra ura monument kulturore rrezikohen në zona të ndryshme të Shqipërisë nga dëmtimet që kanë pësuar në vite dhe mungesa e mirëmbajtjes.

Urat u shërbejnë komuniteteve të vogla të banorëve, por edhe turizmit kulturor dhe natyror, thotë Geri Emiri që drejton Qendrën "Amfora", e cila ka

ndërmarrë një nismë për mbrojtjen e këtyre urave. "Ne shikojmë që në të gjithë territorin e Shqipërisë ka problematika të ndryshme me urat që janë Monumente Kulturore. Përgjatë dimrit ato pësojnë dëme të ndryshme dhe autoritetet e kulturës duket qartësisht që përgatisin projektet, por mungojnë më pas ndërhyrjet restauruese", tregon ai.

Emiri thotë më tej se duhet një ndërgjegjësim më i madh për mbrojtjen e urave monumentale, si një pasuri e rrallë e Shqipërisë.

"Dëmtimi dhe shkatërrimi i disa prej këtyre urave që janë dhe Monumente Kulturore ka ndërprerë në vetvete edhe komunikimin e banorëve të këtyre zonave. Është kjo një arsye më shumë që ata t'i braktisin fshatrat dhe rrjedhimisht që, përveç Monumenteve të Kulturës, shikojmë një braktisje totale, si dhe humbje të një pjese të trashëgimisë sonë historike".

Krahas autoritetit rrugor dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, edhe qeveritë vendore kanë përgjegjësitë e tyre për mirëmbajtjen e urave, sidomos atyre rurale, por shumë prej bashkive thonë se kanë pamundësi financiare për t'i mbuluar financiarisht ndërhyrjet.

## Policia e Kosovës pajiset me automjete të reja për nevoja operative

Prishtinë, 18 nëntor - Policia e Kosovës ka përforcuar kapacitetet e saj me automjete, duke pranuar një numër të automjeteve të tipit kombibus, të cilat do të shërbejnë për mbështetje të njësive speciale-policore gjatë operacioneve dhe aksioneve të veçanta.

Ky furnizim ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve të transportit, duke siguruar

transport efikas dhe të sigurt për efektivat policore në terren.

Automjetet do ta lehtësojnë lëvizjen e njësive speciale, duke mundësuar një përgjigje më të shpejtë dhe më të organizuar në situata të ndryshme operative.

Projekti i furnizimit me automjete të reja është një hap i rëndësishëm për forcimin e infrastrukturës dhe aftësive

operacionale të Policisë së Kosovës, duke kontribuar drejtpërdrejt në realizimin e misioneve të saj për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike në të gjithë territorin e Kosovës.

Policia e Kosovës mbetet e angazhuar për forcimin e sigurisë dhe rendit publik, me qëllim ofrimin e një mjedisi më të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës.



## Shëndeti mendor i fëmijëve, Qelaj: Ka mungesë të mekanizmave për identifikimin e hershëm

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 18 nëntor - Në Kosovë ka mungesë të mekanizmave për identifikimin e hershëm të fëmijëve që përballen me sfida të shëndetit mendor, kështu tregojnë të gjeturat preliminare të raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për shëndetin mendor të fëmijëve. Në tryezën e diskutimit, ku u diskutua për këtë çështje, u theksua edhe nevoja për numër më të madh të psikologëve në shkolla.

Avokati i Popullit, Naim Qelaj, tha se korniza ligjore nuk siguron ofrim të mbështetjes së specializuar dhe psikologjike në nivel të komunitetit. "Ka një mungesë të mekanizmave sistematikë për identifikimin e hershëm të fëmijëve që përballen me sfida të shëndetit mendor. E dyta ka të bëjë me qasjen e kufizuar në mbështetjen e specializuar psikologjike në kujdesin parësor dhe dytësor. Korniza ekzistuese ligjore nuk siguron ofrimin e mbështetjes së specializuar dhe psikologjike në nivel të komunitetit. Sfidat tjetër ose e gjetura tjetër që vazhdon të dalë si rezultat i gjetjeve të hulumtimit ka të bëjë me shërbime të



pamjaftueshme të shëndetit mendor për fëmijët në nivelin dytësor. Pastaj numri i ulët i profesionistëve të shëndetit mendor, përfshirë psikiatër të fëmijëve dhe psikologë klinikë, si në nivelin dytësor ashtu edhe në nivelin tretësor të kujdesit", ka deklaruar Qelaj.

Në diskutimin për shëndetin mendor të fëmijëve, Avokati i

Popullit ka potencuar edhe nevojën për numër më të madh të psikologëve në shkolla. "Stigma dhe perceptimi negativ për shërbimet në institucionet si barrierë për kërkimin e ndihmës psikologjike. Unë u interesova dhe pashë që në disa hulumtime që janë kryer gati 20 për qind të fëmijëve që kanë probleme të shëndetit mendor

marrin trajtim të kujdesit shëndetësor, nuk kanë një gatishmëri as të fëmijët as të prindërit dhe kujdestarët e tjerë që të marrin një shërbim të tillë. Dhe kjo pa dyshim paraqet problem. Numri i vogël i psikologëve në shkolla që rrjedh edhe si rezultat i vet kornizës ligjore dhe përcaktimit të psikologëve në

shkolla bazuar në numrin e nxënësve që shpeshherë një numër të madh të fëmijëve i lë pa përfshirje të këtij kujdesi", ka theksuar Avokati i Popullit.

Në diskutimin për shëndetin mendor të fëmijëve, shefja e Psikiatrisë së Fëmijëve në QKUK ka kritikuar institucionet sa i përket ndarjes së buxhetit për fëmijët dhe adoleshentët. "Fillimisht kemi një shkelje flagrante të ligjit qysh në themelimin e dokumenteve, për arsye se fëmijët dhe adoleshentët përbëjnë një popullatë vunerabel dhe nuk mund të përfshihen në planet strategjike për të rritur. D.m.th plani strategjik i cili po krijohet aktualisht nuk ka asnjë përfaqësues të fëmijëve dhe të adoleshentëve, që i bie 0-18 vjet. Buxheti është zero për 24 vjet. Çdo plan strategjik nuk parashikon buxhet për fëmijët dhe adoleshentët", u shpreh ajo.

Ndërkaq, Merita Bajraktari Januzi nga Ministria e Arsimit tha se po punohet në funksion të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Në këtë tryezë diskutimi për shëndetin mendor të fëmijëve kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga qendrat për punë sociale, Policia e Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë.

## Procesi i riakreditimit, shumë takime për një universitet të shekullit XXI

Prishtinë, 18 nëntor - Të hënën dhe të martën ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim do të zhvillojë takime në Rektorat dhe në hapësira të tjera të Universitetit të Prishtinës në kuadër të procesit të riakreditimit institucional.

Në ditën e parë të ngjarjes më të rëndësishme për Universitetin e Prishtinës, rektori Arben Hajrullahu me prorektorët Albana Berisha Qehaja, Avni Hajdari, Naim Jerliu e Rozafa Basha dhe zëvendëskryesuesen e Këshillit

Drejtues, Arbresha Turjaka, janë takuar me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe përfaqësuesve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Ekipi i ekspertëve, i përbërë nga profesorët Melita Kovacevic, Magdalena Platis, Mauro Zarrelli dhe zonja Marija Vasilevska, bashkë me zyrtarët e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, drejtorin e përgjithshëm Naim Gashi, drejtorin e Departamentit për Vlerësim dhe Akreditim, Arianit Krasniqi dhe koordinatoren Shpresa Shala, erdhën në Rektorat dhe në

hapësirat e tjera të Universitetit të Prishtinës për t'i parë nga afër ambientet e mësimin, punën e personelit dhe gjithë atë që u ofrohet studentëve në këtë universitet.

Gjatë takimit u zhvilluan diskutime të hapura me pyetje-përgjigje në mes të përfaqësuesve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Menaxhmentit të Universitetit të Prishtinës.

Gjatë dy ditëve të zhvillimit të procedurave të riakreditimit janë paraparë edhe takime të grupit nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës me



trupat e Universitetit të Prishtinës për sigurim të cilësisë, profesorët, studentët dhe të diplomuarit. Në fund, vizita e ekspertëve

dhe përfaqësuesve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim do të përfundojë pas takimit përmbyllës me menaxhmentin e Universitetit të Prishtinës.

## Rritje e lehtë e sasisë së mbeturinave komunale në vitin 2023

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale (AMK) për vitin 2023. Rezultatet e paraqitura në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori. Të dhënat e AMK 2023 tregojnë se gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2023 ishte 490 mijë tonë/vit që,

krahasuar me të dhënat e vitit 2022, ka rritje prej 0,4 %. Të dhënat e vitit 2023 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë ishte 278 kg/banorë/vit, ndërsa mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë në Kosovë ishte 0.76 kg/banorë/ditë. Në Prishtinë dhe rajonin e saj, mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë ka qenë

0.83 kg. Në rajonet e tjera të Kosovës mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë ishte 0.74 kg. Sasia më e madhe e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2023 ishte në rajonin e Prishtinës 149 mijë t/vit, ose 30,4 %, ndërsa sasi më e vogël e mbeturinave komunale të grumbulluara ishte në rajonin e Gjilanit 41 mijë t/vit, ose 8,5 %.



## AKK-ja: Buxheti 2025, i pamjaftueshëm për komunat

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Buxheti vjetor komunal është thelbësor për financimin e projekteve të ndryshme. Ai siguron shërbime cilësore për qytetarët dhe kontribuon në zhvillim ekonomik në nivel komunal. Por për buxhetin e planifikuar për komunat për vitin 2025 ka shfaqur pakënaqësi Asociacioni i Komunave të Kosovës. Të pamjaftueshëm po e quan buxhetin e planifikuar për vitin 2025 Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Drejtori ekzekutiv, Sazan Ibrahim, tha se me buxhetin e planifikuar, komunat e Kosovës do të përballen me ulje të fondeve nga buxheti shtetëror. "Sipas analizave të asociacionit, komunat do të kenë mangët mjete në raport me vitin e kaluar. Me buxhetin e planifikuar për vitin 2025 komunat do të marrin 21.8 % të buxhetit në total, kurse gjatë vitit 2024 kanë përfituar rreth 22.4 %, shtu këtu edhe problemim me kontratat kolektive ku komunave u janë marrë



padrejtësisht mbi 60 milionë euro", tha ai për RTK-në. Përveç kësaj, problem në këtë situatë, sipas tij, është edhe mosmiratimi i Grantit IV për investime kapitale, si dhe fakti ku mbi 60 milionë euro janë hequr nga buxhetet komunale deri tani gjatë këtij viti për zbatim të kontratave kolektive. Ai shton se në ndarjet

buxhetore, qeveria ka bërë dallime nëpër komuna. Mirëpo kryetari i Komisionit Parlamentar për Buxhet, Armend Muja, nuk pajtohet me Ibrahim. Ai thotë se buxheti i ndarë për komunat ka shënuar rritje vitet e fundit. "Për komunat për vitin 2025 janë paraparë 788 milionë euro. Krahasuar me kohën kur ne nuk


ishim në pushtet, kanë qenë të alokuara 544 milionë euro. Që nga koha kur kemi ardhur, për komunat ka pasur rritje të buxhetit në vlerë 247 milionë euro. Përveç grantit të rregullt është edhe ai në kuadër të buxhetit për infrastrukturë, diku 50 milionë euro, në bashkëfinansim me komunat për projektet kapitale. Pra, veç

këtij buxheti është edhe një buxhet tjetër që u është alokuar komunave", theksoi Muja. E për kontratat kolektive Muja thotë se po diskutojnë për mënyrën se si do të trajtohet çështja e tyre.

Njohësit e fushës së ekonomisë thonë se problemi nuk qëndron te planifikimi sa te mosrealizimi i projekteve kapitale. "Nuk ka ndonjë efekt të madh kur kemi parasysh se në vitet e fundit jemi përballuar me sfida dhe niveli i të ardhurave që është paraparë për disa kategori, nuk janë të mjaftueshme për mbulimin me normën e inflacionit. Nuk pres ndonjë risi që do të ndikojë, vetëm është një vazhdimësi e saj çfarë ka ndodhur në vitet e kaluara", tha për RTK-në Bashkim Mustafa, njohës i çështjeve ekonomike. Sipas një analize të publikuar nga Instituti GAP për "Planifikimet buxhetore" të komunave për vitin 2025", 15 komunat e përfshira tregojnë se ka një rritje prej 2-11 % të buxheteve vjetore për vitin 2025.

## Bie indeksi i përgjithshëm i inputeve bujqësore

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeks të Inputeve Bujqësore për tremujorin e tretë (TM3) 2024. Ky publikim është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinare, në kompani, tregje dhe vende të tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Produktet të cilat e përbëjnë bazën për indeksin e çmimit të inputeve janë të ndara në dy



grupe kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi

(Input 1) dhe mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input

2). Në TM3 2024, Indeksi i Input1 ka rënie për (-6,9 %), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Indeksi i Input 2 ka rritje për (3 %), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rënie për (-2,3 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Brenda grupit të mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji;

vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për veterinarin, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime tjera. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje të tjera), ndërtesat dhe të tjera (ndërtesat jorezident të fermës, punët e tjera përveç përmirësimit të tokës).

## KESCO apelon për konsum nën 800 kWh

Prishtinë, 18 nëntor - Sezoni i ftohtë ka nisur e konsumi i energjisë është duke arritur pikun. Lidhur me këtë, Kompania e Kosovës për

Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) u ka bërë thirrje konsumatorëve të mbajnë konsumin nën 800 kWh. "Sezoni i ftohtë ka nisur dhe

konsumi i energjisë po arrin pikun e tij. Ju lutemi të mbani konsumin tuaj mujor nën 800 kWh. Duke kursyer përfitoni fatura më të ulëta dhe

ndihmoni funksionimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergetik për të gjithë", thuhet në njoftimin e KESCO-s.





# Dhjetë gjërat për të cilat i detyrohemi Revolucionit Francez

Nga Khalid ELHASSAN

Revolucioni Francez i vitit 1789, kishhte një ndikim më të madh politik, intelektual dhe kulturor, në krahasim me çdo revolucion tjetër në histori. Ai shënoi një ndryshim global nga monarkitë absolutiste që e kishin qeverisur shumicën e njerëzimit për gati të gjithë historinë e regjistruar, tek demokracitë, republikat dhe shtetet moderne. Liberalizmi, laicizmi, nacionalizmi, radikalizmi, socializmi, feminizmi: të gjitha rrjedhin nga Revolucioni Francez. Po kështu edhe socialdemokracia, komunizmi dhe fashizmi. Ja cilat janë 10 gjërat, për të cilat i detyrohemi këtij revolucionit.

## 1. Fundi i feudalizmit, dhe i të drejtës hyjnore të mbretërve

Një nga hapat e parë të Revolucionit Francez, ishte të



shfuqizonte monarkinë absolutiste, dhe ta zëvendësonte atë me një kushtetutë, që i përgjigjej nevojave të gjithë kombit. Të gjitha privilegjet aristokratike u hoqën. Po kështu u veprua gradualisht, edhe në pjesën tjetër të Evropës.

## 2. Përhapja e të drejtave të njeriut

Në gushtin e vitit 1789, Asambleja Kombëtare Kushtetuese e Francës, miratoi Deklaratën për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit. Dokumenti, i përbërë nga 17 nene që përfshinin parimet e Iluminizmit, të cilat frymëzuan Revolucionin Francez, ishte një statut i rëndësishëm i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai mishëronte konceptin, se individit duhet të ruhet nga veprimi arbitrar i shtetit, dhe do të shërbejë si preambulë e Kushtetutës franceze të vitit 1791, dhe e kushtetutave të

mëvonshme. Deklarata, revolucionarizoi marrëdhënien midis qytetarit dhe shtetit – ose të paktën të kuptuarit se çfarë duhet të jetë kjo marrëdhënie.

## 3. Nacionalizmin modern

Farat e nacionalizmit francez, u mbollën që në Luftën Njëqindvjeçare, kur territori i asaj që do të bëhej Franca, ishte rrënuar nga pushtuesit anglezë. Por vetëm gjatë rrjedhës së Revolucionit Francez, do të lindte nacionalizmi siç kuptohet zakonisht në epokën moderne. Marrëdhënia e re e qytetarit me kombin, u mishërua në një këngë të re revolucionare, Marsejeza, që do të bëhej himni kombëtar i Francës. Kënga nuk lartësonte një monark apo komandant ushtarak, por ishte një thirrje patriotike për të mobilizuar të gjithë qytetarët për të luftuar për kombin, dhe për të penguar depërtimin e pushtuesve të huaj.



Në vitin 1801, Napoleoni arriti një marrëveshje (Konkordat) me Kishën, që normalizoi dhe rregulloi marrëdhëniet mes Kishës Katolike dhe Francës. Konkordati mbeti në fuqi deri në vitin 1905, kur Franca përfundimisht vendosi një ndarje të plotë midis Kishës dhe shtetit.

## 6. Thjeshtëzimi i modës së të veshurit

Gjatë shekullit XVIII, tekta oborri mbretëror dhe qeveria franceze u bënë gjithnjë e më shumë të korruptuar, moda e lidhur me regjimin nisi të shihej si një nga simbolet që duheshin rrëzuar.

Kur u përmbys regjimi i vjetër, rrobat e mbi ngarkuara u zëvendësuan nga një lloj anti-mode, që e vuri theksin tek thjeshtësia dhe modestia për burrat dhe gratë. Kështu nuk u hoq dorë nga përdorimi i parukeve nga burrat dhe i kapeleve shumëgjyreshë. Ato u zëvendësuan nga veshje e thjeshta, dhe pantallonat e ngushta

## 7. Sistemi metrik

Para Revolucionit Francez, njësitë e peshës dhe matjeve të tjera ndryshonin jo vetëm midis vendeve, por edhe midis

rajoneve të ndryshme, madje edhe midis qyteteve. Nevoja për një sistem uniform ishte mëse e qartë për njerëzit e arsimuar, shkencëtarët dhe tregtarët në të gjithë Evropën.

Sistemi i një metrike të përbashkët u propozua për herë të parë në Asamblenë Kombëtare në vitin 1791. Një metër u përcaktua si një dhjetë milionta e distancës midis Polt të Veriut dhe Ekuatorit. Një liter, ishte vëllimi i një decimetri kub. Një kilogram, ishte pesha e një litri uji të pastër e kështu me rradhë.

## 8. Kodi i Napoleonit

Kodin Civil Francez i miratuar më 1804, u bë i njohur si Kodi i Napoleonit. Roli i Kishës u zbeh ndjeshëm, krahinat u transformuan në nëndarje të një shteti të ri kombëtar. Kodi iu nënshtrua rishikimeve të ndryshme në shekuj që nga miratimi i saj, por mbetet në Francë edhe sot e kësaj dite. Sot, shumica e njerëzimit – me përjashtimin e dukshëm të vendeve anglosaksone, jetojnë nën Kodin Napoleonik ose derivatet e tij.

## 9. Përhapja e republikave


Sovraniteti popullor, qeveria përfaqësuese dhe sundimi i

ligjit, ishin idealet e shprehura të qeverisë revolucionare franceze. Përhapja e këtyre parimeve republikane në të gjithë Europën, u pa si një fund i dëshirueshëm në vetvete, dhe gjithashtu si një mjet parandalues për të mbrojtur Revolucionin Francez në shtëpi. Prandaj, dhjetra “republika motra”, të madhësive të ndryshme, u krijuan në vitet 1790 dhe përfundimisht u konsoliduan në disa republika të mëdha rreth kufijve të Francës.

## 10. “Liri, barazi, vëllazëri”, dhe shtrirja e idealizmit shekullar

“Liberte, Egalite, Fraternite”, ishte një moto e hershme e Revolucionit Francez që shprehte idealet dhe aspiratat e tij. Ky term, hyri shpesh në leksikon revolucionar popullor. Në praktikë, Revolucionarët u rrëzuan pa arritur të vënë tërësisht në zbatim moton e tyre. Sidoqoftë, Liria, Barazia, Vëllazëria, ashtu si idealet e Revolucionit Amerikan, ishin dhe mbetën aspiratat e përhershme tërheqëse për idealistët.

Burimi: HistoryCollection – Bota.al





**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT  
 PILKINGTON  
 Enveri  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## ‘Dardanët’ synojnë të dalin mirë nga sfidat e nëntorit

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll është duke u përgatitur për ndeshjet e nëntorit, të vlefshme për parakualifikimet evropiane për Kupën e Botës 2027. “Dardanët” kanë nisur të ushtrorin nga e marta e javës së kaluar nën udhëheqjen e përzgjedhësit të ri, Jean-Denys Choulet. Sipas

Federatës së Basketbollit, stërvitjet po shkojnë mjaft mirë dhe të gjithë basketbollistët po e japin maksimumin, derisa atmosfera në kampin dardan është mjaft e mirë. Ekipi ka ushtruar në palestrën “1 Tetori” në Prishtinë. “Dardanët” në muajin nëntor do t’i zhvillojnë dy ndeshje si mysafirë. Më 21 nëntor do të ndeshen me

Zvicrën dhe më 24 ndaj Irlandës. Kosova e ka një fitore dhe një humbje deri tash. Sfidat e fundit do të jenë në shkurt të vitit të ardhshëm, kur do ta presim Zvicrën dhe Azerbajxhanin. FBK-ja u ka bërë thirrje bashkatdhetarëve t’i mbështesin “Dardanët” në këto dy sfida të rëndësishme.



# Kosova triumfon ndaj Lituanisë

### “Epoka e re”

PRISHTINË, 18 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës shënoi fitore të rëndësishme, me rezultat 1:0 ndaj Lituanisë në ndeshjen e fundit të fazës grupore të Ligës së Kombeve, të hënën mbrëma në stadiumin “Fadil Vokrri”. Fitorja ia Dardanëve pozitën e dytë në Grupin C2, me 12 pikë të grumbulluara, ndërsa Lituania e mbylli kampanjën pa asnjë pikë. Rumania kryeson grupin me 15 pikë, ndërsa rezultati përfundimtar i ndeshjes së ndërprerë mes Kosovës dhe Rumanisë është ende në pritje të vendimit të UEFA-s. Kosova e nisi ndeshjen me shumë intensitet dhe arriti të kalojë në epërsi që në minutën e pestë. Albion Rrahmani fitoi një top të rëndësishëm në gjysmëfushën kundërshtarë dhe pasoi për Vedat Muriqin, i cili i dha një

asistim të përkryer Muharrem Jasharit, i cili nga brendësia e zonës realizoi gol të bukur, duke ndezur entuziazmin e tifozëve në stadium. Megjithatë, në minutat shtesë të pjesës së parë, Jashari u ndëshkua me karton të kuq pas një ndërhyrjeje të pakontrolluar në mesfushë. Fillimisht, gjyqtari kryesor i dha karton të verdhë, por pas rishikimit në VAR, vendimi u ndryshua dhe Jashari u përjashtua nga loja. Luajtja me një lojtar më pak gjatë gjithë pjesës së dytë e vuri Kosovën nën presion, por portieri Aro Muriq tregoi formë të shkëlqyeshme, me disa pritje vendimtare. Megjithatë, mbrojtja dhe shpirti luftarak i “Dardanëve” bëri që të menaxhohet epërsia e hershme dhe të arkëtohen tri pikë. Me këtë fitore, Kosova e ka siguruar së paku vendin e dytë në grup, që i garanton një vend në “play-off”-in për Ligën C.



# Kryeministri rumun i reagon Kurtit: Mos e përziej politikën me sport, kot e kthen fajtorin në viktimë



Bukuresht, 18 nëntor - Kryeministri Albin Kurti është akuzuar nga homologu i tij rumun Marcel Ciolacu se po e përzie politikën me sportin, teksa fajin ua ka lënë futbollistëve të Kosovës. “Është krejtësisht e papranueshme të përzihen politika me sportin,

siç po bën tani kryeministri i Kosovës, pas gjestit të ekipit të tij kombëtar të futbollit që braktisi ndeshjen kundër Shqipërisë, duke thënë se do të ushtrorë presion politik dhe diplomatik për të na ndëshkuar!”, ka shkruar Ciolacu në “Facebook”. “[Kurti]

po mundohet kot ta kthejë fajtorin në viktimë dhe – më keq akoma – po kërkon të ushtrorë presion politik mbi forumet e futbollit evropian, duke shpresuar në një vendim iluzor! I them drejtpërdrejt dhe qartë se sa do që të mundohet, nuk mund të manipulohet me

realitetin dhe se gjithsesi po ecën në një rrugë të gabuar, sepse politika nuk ka vend në sport”. Futbollistët e Kosovës braktisën fushën në Bukuresht të premtën pak para përfundimit të ndeshjes pas koreve “Serbia, Serbia” të tifozëve rumunë.

## Istogu eliminohet nga garat evropiane

Istogu, 18 nëntor - KHF Istogu është eliminuar nga skuadra çeke Hazena Kynzhvart në raundin e tretë të EHF European Cup, por istogaset kanë luajtur ndeshje dukshëm më të mirë të dielën mbrëma në Cheb sesa që luajtën të dielën e kaluar në Prishtinë.

Në një ndeshje plotësisht të barabartë, skuadra çeke fitoi me rezultat 34:32. Kështu Istogu dëshmoi se humbja e thellë në ndeshjen e parë nuk ishte pasqyrë e cilësisë që ka. Pjesa e parë ishte plotësisht e barabartë, ndërsa për kohë të gjatë Istogu ishte në epërsi.

Në fund skuadra çeke u shkëput dy gola, 17:15. Në pjesën e dytë Hazena Kynzhvart u shkëput pesë gola (26:21), por Istogu barazoi në 29:29 e më pas në 31:31. Në fund të ndeshjes dallimi ishte dy gola, 34:32. Nga tetë gola për Istogun i kishin Maria

Vitoria Vicentini Campos (8/9) dhe Astou Ndiaye (8/10). Pesë gola i shënoi Lana Paviçević (5/10). Suzana Ujkiq i shënoi tri gola (3/3) sa edhe Dijana Ujkiq (3/5). Blerta Ahmetxhekaj i kishte gjashtë pritje e Viktoriia Mykhailenko katër.



## Kumbulla: Kalimi tek Espanyoli, vendim i duhur

**BARCELONË, 18 NËNTOR** - Pas disa sezoneve shumë të vështira, mbrojtësi shqiptar Marash Kumbulla po gjen vazhdimësinë tek Espanyoli që i mungonte prej shumë kohësh në Itali. Gjithashtu, për shkak të një dëmtimi të rëndë, qendërmbrojtësi

shqiptar nuk ishte më në gjendje të luante vazhdimisht dhe përkundrazi te klubi me qendër të Barcelonës gjeti vazhdimësinë: "Ishte e vështirë, por pas një dëmtimi të tillë duhet shumë kohë për t'u rikthyer si më parë. Tani mendoj se është vetëm çështje

qëndrueshmërie dhe të luash sa më shumë që të jetë e mundur. Ardhmja ime në Barcelonë ishte zgjedhja e duhur". Kumbulla u transferua nga Roma tek Espanyol në mënyrë të përkohshme verën e kaluar dhe ka edhe dy vjet kontratë me klubin

verdhekuq. "Shoku im në futboll? Nëse më duhet të përmend një emër, do të thosha Edoardo Bove. Ai është me të vërtetë një djalë i artë, shumë inteligjent. U lidhëm shumë dhe unë gjithmonë e ndjek me shumë dashuri", ka deklaruar mbrojtësi shqiptar.



## KH Rahoveci: Ejani na përkrahni që të shkruajmë historinë

**RAHOVEC, 18 NËNTOR** - KH Rahoveci, pasi e shkroi historinë e sportit në Kosovë, tash po vazhdon ëndrrën përrallore në Evropë, duke kaluar në raundin e tretë të EHF European Cup në hendboll me mposhtjen e kampionit belg, Bocholt. Tashmë më 23 nëntor, nga ora 19:00, e ka rastin ta shkruajë historinë. Në "Mizahir Isma", në ndeshjen e parë pret ekipin rumun CS Minaur Baia Mare dhe një javë më vonë i shkon këtij klubi në Rumani për ndeshjen e kthimit. "Në historinë e sportit kosovar, Besa Famgas më së largu në këto nivele ka arritur aty ku jemi edhe ne tani për herë të parë, andaj me një fitore eventuale bëhemi ekipi i parë vendor që kualifikohet në 16 më të mirat e EHF European Cup", thuhet në njoftimin e kësaj skuadre. Klubi rahovecas ka një mision jashtëzakonisht të vështirë, pasi përballë e ka një ekip me përvojë të jashtëzakonshme në këto nivele. Ndërsa duhet cekur se klubi rumun është një nga favoritët e kësaj gare. CS Minaur Baia Mare



është tri herë kampion rumun, gjashtë herë fitues i kupës, dy herë fitues i EHF Cup, gjysmëfinalist i edicionit të fundit të EHF European Cup dhe finalist në vitin 2022. Ka pjesëmarrje edhe në Ligën e Kampionëve. Përkundër disa vështirësive financiare me të cilat përballlet, ka ekip kompakt me lojtarë shumë të fortë. "E gjithë kjo paraqet veç një motiv shtesë për

ne. Duam të dëshmojmë se jemi të gatshëm për ndeshje të këtyre niveleve dhe do të japim gjithçka nga vetja. Por, do të jetë definitivisht e pamundur pa përkrahjen tuaj masive në Rahovec. Andaj, orarin e dini, adresën po, veç na ka mbetur të luftojmë bashkë, për të hyrë në librat e historisë së hendbollit kosovar", thuhet në njoftimin e Rahovecit.

## Clevelandi vijon të befasojë në NBA, Dallasi triumfon në sekondat e fundit ndaj Oklahomës

**OHIO, 18 NËNTOR** - Clevelandi mbetet i pamposhtur në NBA, duke korrur suksesin e 15 radhazi. Cavaliersi fitoi me rezultat 128-114 ndaj Charlottes (4 lojtarë realizuan mbi 20 pikë), duke u bërë skuadra e katërt në historinë e NBA-së që regjistron këtë rekord (15 fitore, 0 humbje) në startin e një sezoni. Skuadra e Memphisit arrin të mposhtë me rezultat 104-90 Denverin, ndeshje ku për vendasit u dallua Jaren Jackson me 20 pikë. Fitore në sekondat e fundit korri Dallasi, që mundi me rezultat 121-119 Oklahomën. Vendimtar stoli i ekipit teksan,



nga ku erdhën 50 pikë, ndërkohë që P. J. Washinton me 27 pikë ishte lider. Pa probleme fiton ekipi i Clippersit, që falë 22 pikëve të Zubacut e 20 të Hardenit, mundi me shifrat 116-105 Utah Jazzin. Triumfoi

REZULTATET	
Cleveland - Charlotte	128-114
Memphis - Denver	105-90
Portland - Atlanta	114-110
Washington - Detroit	104-124
Chicago - Houston	107-143
New York - Brooklyn	114-104
Oklahoma - Dallas	119-121
Clippers - Utah Jazz	116-105

edhe ekipi i Houstonit, që mundi thellë me shifrat 143-107 Chicagon jashtë fushe (7 lojtarë me nga 10 pikë), ndërsa Portlandi mundi me rezultat 114-110 Atlantian, ndeshje ku u dallua Sharpe me 32 pikë.

## Barça synon transferimin e Parteyt dhe David

Barcelona ka shumë yje në skuadër, por duket se do të forcohen edhe më shumë. "Katalanasit" e Barcelona janë prej kohësh në krizë financiare dhe e kanë pasur goxha të vështirë për të transferuar lojtarë, ama kjo nuk i ndalon për të afruar lojtarë me

parametra zero. "Shkatërruesi" Thomas Partey i Arsenalit dhe sulmuesi kanadez i Lilles, Jonathan David, janë në "radarët" e "blaugranave", me drejtorin sportiv të klubit, portugezin Deco, që ka nisur negociatat për të afruar lojtarët pa shpenzuar para, në

përfundim të kontratave me klubet respektive, kontrata që skadojnë në fundin e këtij sezoni. Sa i përket mundësisë së realizimit të këtyre transferimeve, Partey tashmë është kthyer në një lojtar stoli tek Arsenal dhe mendohet se dëshiron një aventurë të re,

pavarësisht se Mikel Arteta e detyroi të qëndrojë në Londër, gjatë merkatos së verës. Në krahu tjetër, Jonathan David duket të jetë gati për "hapin e madh" në karrierë me "bomberin" e sulmit, i cili e ka njoftuar klubin se do të largohet si lojtar i lirë në fundin

e sezonit, teksa deri më tani ka shënuar 9 gola e ka asistuar 2 të tjerë në 11 përballje. Në listë është një tjetër portier pas afrimit të polakut Szczesny, emri i të cilit ende nuk është vendosur, për shkak të dëmtimit të rëndë të Marc-Andre ter Stegen.

### SHKURT

#### Lara Colturi nuk e mbyll dot zbritjen e dytë në sllalom në Finlandë

Në pistën e Levit, në Finlandë, u zhvillua gara e sllallomit për femra, e vlefshme për Kupën e Botës në ski. Në këtë garë mori pjesë edhe skiatorja 18-vjeçare shqiptare Lara Colturi. Ajo bëri një paraqitje të mirë në zbritjen e parë, ku dha kohën 54"53 dhe avancoi mes skiatoreve më të mira, që vijuan garën. Gjithsesi, Colturi nuk arriti ta mbyllte zbritjen e dytë, duke mos dhënë dot një kohë të përgjithshme. Kjo ishte gara e dytë sezonale për Lara Colturin, pas asaj në Soelden (sllallomi gjigant), ku u rendit në vendin e 16 dhe grumbulloi 15 pikë në Kupën e Botës. Ajo vijon përgatitjen për sfidën e radhës.

#### Sinneri triumfon në 'ATP Finals' pa humbur asnjë set

Tenisti italian Jannik Sinner u shpall fitues i turneut "ATP Finals", event ku marrin pjesë tetë tenistët më të mirë në botë, zhvilluar në Torino. Përballë publikut të tij, Sinner fitoi 2-0 në finale ndaj amerikanit Taylor Fritz (6-4, 6-4). Sinner, numri 1 në botë për meshkuj, fiton për herë të parë këtë turne, ku arriti të triumfojë në të pesë takimet e luajtura (tri në grup, gjysmëfinalen e finale). Madje ai nuk humbi asnjë set në këtë turne, çka tregon dominimin e tij. Këtë vit Sinner ka fituar edhe dy grand slam, atë të Australian Open dhe US Open, duke korrur në total 70 fitore përgjatë gjithë sezonit 2024. "Ky është një vit i jashtëzakonshëm për mua. Jam i lumtur", ka thënë Sinner.

#### Musiala: Ka ardhur koha të fitojmë trofe

Gjermania po kalon një moment shumë pozitiv në Ligën e Kombeve. Kombëtarja e drejtuar nga trajneri Julian Nagelsmann ka siguruar vendin e parë në grup. Ndeshja e fundit është ajo ndaj Hungarisë, e cila zhvillohet nesër në mbremje, ndërkohë që dy ditë më parë mposhti thellë 7-0 Bosnjë-Hercegovinën. Një nga protagonistët e këtij ekipi është sulmuesi Jamal Musiala, i cili tashmë kërkon të fitojë trofe. "Ndaj Bosnjës ishte një ndeshje shumë argëtuese. Në fakt, po argëtohem me këtë kombëtare. Sa më shumë të shënojmë aq më shumë argëtohem në fushë. Ne thjesht po luajmë futboll. Është kënaqësi për të gjithë të jesh në fushë me këtë grup. Kemi punuar shumë edhe në mbrojtje, ndaj po vijnë rezultate të mira. Mendoj se ka ardhur koha që të fitojmë një trofe, pasi jemi në një nivel të mirë", ka deklaruar Musiala.

**NJOFTIMI PËR TAKIM**

“EV Wind Park Sh.p.k.” synon të ndërtojë dhe operojë “Centralin e Erës Zatrik I&II” me 12 turbina ere dhe një kapacitet total të instaluar prej 70 MW në Zatric, Rahovec. Një raport i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (ESIA) është përgatitur për projektin. Do të mbahet një “Takim i Pjesëmarrjes Publike” për të informuar palët e interesuara rreth studimit të ESIA-s mbi Projektin dhe për të mbledhur komentet dhe sugjerimet e tyre. Data, vendi dhe koha e mbledhjes janë dhënë më poshtë. Të gjithë palët e interesuara janë të ftuara në takim.



Vendndodhja:

Adresa: Shkolla fillore e mesme e ulët “Dëshmorët e Zatriqit”

Lokacioni; zatriq Data: 27 nëntor 2024

Koha: 11:00

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Marketing Plus” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 71062465 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Marketing Plus” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 71062465 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability “Marketing Plus” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 71062465 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Arber Breznica nga Miradia e Epërme shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Hivzi Sylejmani” Fushë Kosovë.

Fitore Morina Nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Shqipe Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. “Hasan Prishtina”.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# TRADITË QË NGA

# 1992

